

## I. Çfarë quajmë Sipërmarrje investimesh kolektive (SIK)?

Përkufizimi pozitiv i SIK-ve përbëhet nga këto elementë:

- Forma ligjore: person juridik ose bashkim asetesh
- Qëllimi: rritje e pjesëmarrjes në para
- Tipi i investimit: investim të mbi 60% të pjesëmarrjes në portofol titujsh, depozita e asete të tjera
- Forma e mbikqyrjes së investimeve: Investitorët nuk mbikqyrin dita-ditës marrjen e vendimeve për investimet
- Objektivi: Nxjerrja e përfitimeve për investitorët

Përrjashtohen nga ky përkufizim: bankat, fondet e pensionit, shoqëritë e sigurimit, personat juridikë që investojnë fondet e veta, investimet e përbashkëta familjare dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive që e rrisin kapitalin pa promovim të shitjes së kuotave/aksioneve të tyre ndaj publikut.

Autorizimi i AMF: Asnjë subjekt nuk mund të themelohet ose të kryejë veprimatrinë e administrimit apo tregtimit të kuotave pa autorizimin e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF), përndryshe përbën vepër penale.

Regjistri i i SIK-ve: SIK-et regjistrohen në Regjistrin e Fondeve të Republikës së Shqipërisë, që mbahet nga AMFja, pas dhënies së liçensës për themelimin e funksionimin nga kjo e fundit.

## II. Shoqëritë administruese

Shoqëritë administruese janë subjektet e vetme që mund të themelojnë Sipërmarrje investimesh kolektive, qofshin këta në formën e fondeve apo në formën e shoqërive të investimit.

Shoqëria administruese është shoqëri aksionare, me afat të pacaktuar, në të cilën të paktën 51 për qind të aksioneve ose të së drejtës së votës janë në pronësi të bankave apo të institucioneve financiare. Shoqëria administruese regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me objekt kryesor veprimtarinë e themelimit dhe/ose administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe veprimtari të tjera që parashikohen në këtë ligj.

Vlera minimale e kapitalit themeltar të regjistruar të shoqërisë administruese është 15 625 000 lekë. Objekti i veprimtarisë tregtare të shoqërisë administruese është administrimi i asetëve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, marketimi i tyre, shitja e kuotave apo aksioneve, kryerja e detyrimeve administrative si p.sh mbajtja e librave të llogarive kontabël dhe përgatitja e raporteve financiare. Gjatë kësaj veprimtarie, shoqëria vepron me ndershmëri dhe në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar.

Shoqëria mund të delegojë administrimin e një pjese të portofolit një shoqërie komisionere.

Në të gjitha rastet, shoqëria administruese duhet të jetë e licencuar nga IMF. Kërkesa për t'u pajisur me licencë për kryerjen e veprimtarisë së administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive shoqërohet me dokumente që vërtetojnë natyrën e shoqërisë, përshtatshmërinë e aksionarëve dhe drejtuesve për kryerjen e veprimtarisë në fjalë dhe seriozitetin e planit të biznesit.

Të paktën dy anëtarë ekzekutivë të këshillit të administrimit të shoqërisë administruese duhet të kenë njohurinë profesionale dhe përvojën e duhur për administrimin e veprimtarive të shoqërisë administruese. Kriteret e kualifikimit janë të parashikuar në mënyrë të detajuar nga ligji.

### **III. Veprimtaritë jashtë Republikës së Shqipërisë dhe veprimtaritë e sipërmarrjeve të huaja në Republikën e Shqipërisë**

#### **A. Veprimtaritë e administrimit të sipërmarrjes së investimeve kolektive jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**

Shoqëria administruese mund të kryejë veprimtari jashtë Republikës së Shqipërisë drejtpërdrejt ose nëpërmjet themelimit dhe funksionimit të një dege, në përputhje me aktet ligjore të vendit përkatës.

Themelimi i degëve në shtetet e Bashkimit Europian dhe në ato të lejuara nga AMF-ja duhet të shoqërohet me një njoftim të AMF-së.

#### **B. Veprimtaritë e administrimit të sipërmarrjes së investimeve kolektive nga shoqëri administruese, me seli të regjistruara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**

Sipërmarrja e themeluar në bazë të licencës së lëshuar nga autoriteti përkatës në një shtet të Bashkimit Europian ose në një shtet, i cili është miratuar specifikisht nga AMF-ja, që përmbush kushtet e parashikuara në dispozitat e këtij ligji, dhe që rregullon funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe që dëshiron të tregtojë kuotat ose aksionet e saj në Republikën e Shqipërisë, duhet t'i paraqesë IMF-së disa dokumente të barazvlefshme me ato që i kërkohen shoqërive me seli në Shqipëri.

## IV. Depozitari

Çdo sipërmarrje e investimeve kolektive, për të cilën kërkohet licencë, emëron një depozitar, i cili duhet të jetë i licencuar nga AMF-ja për të vepruar si depozitari i saj.

Depozitar është një bankë e nivelit të dytë, e cila kryen, për nevoja të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, veprimtarinë për ruajtjen e sigurt të grupimeve të aseteve, administrimin e llogarive të posaçme për asetet dhe veçimin e aseteve të çdo SIK-je individuale nga asetet e SIK-ve të tjera.

## V. Sipërmarrjet e investimeve kolektive

Sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK) mund të jenë me ofertë publike (A) ose me ofertë private (B).

### A. Sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike

#### 1. Llojet e SIK-ve me ofertë publike

Këto shfaqen në dy llojesh: në formën e fondit të investimit (a) ose në atë të shoqërisë së investimit (b).

##### *a) Fondi i investimit*

**Fondi i investimit** është një grupim i veçantë asetesh i paregjistruar si person juridik, i krijuar në bazë të një kontrate, pas licencimit nga AMF-ja, dhe i administruar nga një shoqëri administruese, për grumbullimin e aseteve monetare ose të ngjashme, nëpërmjet ofertës publike të kuotave në fond, asetet e të cilit investohen sipas parimit të diversifikimit të rreziqeve.

Mbajtësit e kuotave kanë të drejtën, jo vetëm të marrin pjesë proporcionalisht në fitimet e fondit, por, gjithashtu, **të kërkojnë, në çdo kohë, shlyerjen e kuotave të tyre.**

**Blerja e kuotave nëpërmjet një oferte publike** kryhet vetëm nëpërmjet pagesës së aseteve monetare ku blerësi, pas blerjes së kuotave, hyn në një marrëdhënie kontraktuale me shoqërinë administruese, e cila është e detyruar të administrojë asetet e paguara si pjesë të aseteve kolektive, në përputhje me kushtet dhe kriteret e treguara në prospekt.

Blerja e kuotave mund të kryhet edhe duke shpërndarë kuota të reja në bazë të shpërndarjes së pjesës në fitim, domethënë kur vlera e kuotave zvogëlohet në bazë të dhënies së kuotave të reja, ose në çdo rast tjetër, të parashikuar nga rregulloret që miraton AMF-ja.

Mbajtësit e kuotave janë përgjegjës për detyrimet e fondit të investimit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në fond.

## **Krijimi i fondit të investimit**

Fondi i investimit mund të krijohet vetëm nga një shoqëri administruese e licencuar, pasi të jetë marrë licenca përkatëse nga AMF-ja.

Aplikimi për licencë dhe aplikimi për regjistrimin e fondit të investimit në Regjistrin e Fondeve, i cili i paraqitet AMF-së nga shoqëria administruese, në emër të fondit, përmban të dhënat në lidhje me emrin e shoqërisë administruese e licencën e saj, si dhe në lidhje me emërtimin e fondit, objektivat, prospektin dhe rregullat e tij, kontratën mes shoqërisë administruese dhe depozitarit etj.

Fondet e investimit janë dy llojesh:

- Fond furnizues**, që është fondi që investon vetëm nëpërmjet një fondi tjetër, që është fondi kryesor. Kuotat shiten tek investitorët nëpërmjet një fondi furnizues, por investohen nëpërmjet fondit kryesor.
- Fond ombrellë** është fondi i investimeve kolektive që ka në pronësi portofole të veçanta asetesh, përfshirë nënfonde ose seri të ndara.

### ***b) Shoqëria e investimit***

**Shoqëria e investimit me ofertë publike** është shoqëri aksionare, me seli në Republikën e Shqipërisë, e themeluar nga shoqëria e administrimit, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare, vetëm pas miratimit paraprak nga AMF-ja.

Objekti i veprimtarisë së saj tregtare është investimi i fondeve në tituj dhe asete të tjera, për shpërndarjen e rreziqeve të investimit dhe dhënien aksionarëve të saj të përfitimit të rezultateve të administrimit të këtyre fondeve, ku të drejtat e investitorëve përfaqësohen nga aksionet e kësaj shoqërie.

### **Themelimi i shoqërisë së investimit**

Aplikimi për licencim dhe aplikimi për regjistrimin e shoqërisë së investimit në Regjistrin e Fondeve i paraqitet AMF-së nga shoqëria administruese dhe duhet të përmbajë një sërë të dhënash të rradhitura në detaj në nenin 59 të ligjit. Shuma minimale e kapitalit të regjistruar duhet të jetë të paktën 40 000 000 lekë.

### **Kostot e shoqërisë së investimit**

Kostot dhe pagesat e lidhura me themelimin e shoqërisë së investimit mund të shlyhen duke debituar asetet e shoqërisë së investimit, vetëm nëse kjo është përcaktuar në prospekt dhe rregullat e fondit. Shuma maksimale e kostove dhe e pagesave të themelimit, që do të shlyhen nëpërmjet debitimit të aseteve të shoqërisë së investimit, shprehen në prospekt si përqindje e aseteve monetare të paguara në shoqërinë e investimit me themelimin e saj. Çdo kosto dhe pagesë tjetër e lidhur me themelimin, që tejkalon përqindjen e përcaktuar në këtë mënyrë, merret përsipër nga shoqëria administruese ose këshilli i mbikëqyrjes, që i ka kryer.

Kostot dhe pagesat e lidhura me themelimin, të cilat shlyhen nga asetet e shoqërisë së investimit, nuk mund të tejkalojnë 3,5 për qind të totalit të aseteve të mbledhura, duke emetuar aksione.

Për sa u përket kostove të tjera, vetëm kostot e mëposhtme mund të paguhen nga asetet e shoqërisë së investimit:

- tarifa e shoqërisë administruese
- tarifa për depozitarin;
- tarifat dhe kostot e këshillit mbikëqyrës;
- kostot, komisionet ose pagesat, që lidhen drejtpërdrejt me blerjen ose shitjen e asetëve të shoqërisë së investimit;
- kostot e pranimet për listim në bursë ose në një treg tjetër të rregulluar;
- kostot e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe të avokatëve, të bëra gjatë kryerjes së veprimtarisë së shoqërisë së investimit, etj.

### **Këshilli mbikëqyrës**

Këshilli mbikëqyrës i një shoqërie investimi duhet të ketë të paktën 5 anëtarë. Të paktën 60% e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së investimit me ofertë publike duhet jenë të pavarur, pra ata nuk mund të jenë të punësuar në shoqërinë administruese, depozitarë, ekspertë kontabël ose persona, të cilëve u është dhënë një licencë e vlefshme nga AMF-ja, për të qenë komisionerë ose këshilltarë investimi dhe që, efektivisht, kryejnë këto veprimtari si punonjës të një shoqërie komisionere ose të një banke të autorizuar për transaksionet me titujt, apo persona, të cilët, në dy vitet e fundit, kanë lidhur një kontratë për ofrimin e shërbimeve me çdonjërin prej tyre. Për të garantuar ndershmërinë dhe profesionalizmin në menazhim, një sërë personash nuk mund të jenë anëtarë të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së investimit.

### **Kompetencat e këshillit mbikëqyrës**

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së investimit me ofertë publike, përveç kompetencave të këshillit mbikëqyrës, dhënë në bazë të ligjit për shoqëritë tregtare, përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë e investimit në lidhje me shoqërinë administruese. Përveç kësaj, këshilli ka edhe kompetenca të tjera të veçanta të listuara në nenin përkatës të ligjit.

## **2. Prospekti**

Prospekti i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike konsiderohet ftesë për blerjen e kuotave në një fond investimi ose të aksioneve në një shoqëri investimi. Informacioni i pasqyruar në prospekt duhet të jetë i saktë dhe i plotë. Prospekti duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që investitorët të jenë në gjendje të bëjnë vlerësimin e duhur të sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe, në veçanti, të rreziqeve që lidhen me të.

## **3. Rregullat e fondit**

Rregullat e fondit të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike rregullojnë marrëdhëniet ligjore ndërmjet shoqërisë administruese dhe mbajtësve të kuotave/aksioneve.

#### 4. Promovimi i SIK-ve

SIK-ët mund të promovohen përmes të gjitha mediave me kushtin që informacioni i përcjellur të jetë i sinqertë dhe i përpiktë.

#### 5. Politikat e investimit

Në një sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike, të paktën 90 për qind e portofolit duhet të përbëhet nga:

- tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit Europian apo në një shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja;
- kuota e fondeve të investimit apo aksione të shoqërive të investimit, të licencuara sipas këtij ligji, si dhe nga kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të licencuara në përputhje me standardet e Bashkimit Europian;
- depozita në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në një shtet të lejuar nga AMF-ja, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo më shumë se 12 muaj;
- instrumente financiare derivativë;  instrumente të tregut të parasë, përveç atyre të tregtuara në një treg të rregulluar.

#### Kufizimet e investimit janë të disallojshem por dy janë më të rëndësishmet:

- Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike nuk mund të investojë më shumë se 5 për qind të aseteve të saj në tituj dhe instrumente të tregut të parasë të një emetuesi të vetëm.
- Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike nuk mund të investojë më shumë se 20 për qind të aseteve të saj në depozita në të njëjtin institucion depozitues.

**Tarifat**, që u ngarkohen mbajtësve të kuotave e fondit të investimit, kufizohen në:

a) tarifën e hyrjes, e cila i shtohet shumës së pagesës në kohën e shitjes së kuotave; b) tarifën e largimit, e cila zbritet nga vlera neto e aseteve të fondit, për çdo kuotë në kohën e shlyerjes; c) tarifa e administrimit, e cila llogaritet ditë për ditë, në bazë të vlerës neto të aseteve të fondit, sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{Tarifa vjetore e raportuar e administrimit} \times 1/365$$

**Kostot operative** të shoqërisë administruese dhe të shërbimeve, të cilat ajo i siguron për fondet e investimit, përveç tarifave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, nuk duhet t'i faturohen fondit, ku përjashtim i vetëm është nënshkrimi i kuotave nga mbajtësit e kuotave, në rastin kur ky shërbim sigurohet nga shoqëria administruese.

Nuk lejohet vendosja e tarifave për rezultatet e veprimtarisë së fondit.

**Kostot e tjera që mund të regjistrohen drejtpërdrejt duke debituar mbajtësit e kuotave:**

- tarifat dhe kostot, që i paguhen depozitarit;
- kostot, komisionet ose shpërblimet për shitblerjen e asetëve;
- kostot e mbajtjes së regjistrimit të kuotave, përfshirë dhe kostot e lëshimit të vërtetimeve të transaksioneve ose vërtetimet e balancës së kuotave, nëse është e nevojshme, si dhe kostot e shpërndarjes së fitimeve;
- kostot e auditimit vjetor;
- kostot e përgatitjes, të shtypjes dhe tarifave postare për raportet gjashtëmujore dhe vjetore për mbajtësit e kuotave;
- të gjitha tarifave dhe shpërblimet e parashikuara, që i paguhen AMF-së, për dhënien e licencës për fondin;
- taksat, që paguhen nga fondi për asetet ose fitimin e tij;
- kostot e komunikimit të ndryshimeve në prospekt dhe komunikimet e tjera të parashikuara;

**B. Sipërmarriet e SIK-ve me ofertë private**

Këta mund të themelohen vetëm si shoqëri investimi, pra nuk mund të përdorin formën e fondit të investimit.

**Shoqëria e investimit me ofertë private** është një shoqëri aksionare, me seli të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, e cila themelohet në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare dhe vetëm pas miratimit të AMF-së. Objekti i veprimtarisë tregtare të kësaj shoqërie është investimi i fondeve, me qëllim shpërndarjen e riskut të investimit, duke u dhënë investitorëve të saj, të afruar përmes ofertës private, përfitimin e rezultateve të administrimit të atyre fondeve. Të drejtat e investitorëve përfaqësohen nga aksionet në atë shoqëri.

**1) Themelimi i shoqërisë së investimit me ofertë private**

Shoqëria e investimit me ofertë private mund të themelohet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe.

Aksionet e shoqërisë së investimit me ofertë private emetohen nëpërmjet një oferte private vetëm në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr.9879, datë 21.2.2008 "Për titujt" dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Në rregullat e fondit dhe prospektin e shoqërisë së investimit me ofertë private përcaktohen edhe objektivat e saj të investimit. Shoqëria e investimit me ofertë private mund t'i ofrojë aksionet e veta vetëm pas regjistrimit në Regjistrin e Fondeve.

AMF-ja miraton një rregullore për të përcaktuar kërkesat e sakta të aplikimit për miratimin e shoqërisë së investimit me ofertë private.

**2) Prospekti i shoqërisë së investimit me ofertë private**

Prospekti i shoqërisë së investimit me ofertë private përbën një ftesë për blerje aksionesh, që i adresohet ekskluzivisht një personi të caktuar ose një grupi të kufizuar investitorësh, që përmbushin kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.9879, datë 21.2.2008 "Për titujt" dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

### **3) Ndalimet për promovimin e shoqërisë së investimit me ofertë private**

Shoqëria e investimit me ofertë private nuk duhet të angazhohet në fushata publike për promovimin e investimit, që ajo administron. Shpërndarja publike e materialeve prezantuese, të cilat, përveç dhënies së informacionit për emërtimin dhe veprimtarinë e shoqërisë së investimit, orienton investitorët potencialë të përshtatshëm për këtë lloj shoqërie, në shoqërinë e investimit me ofertë private, nuk konsiderohet promovim publik.

### **4) Kushtet e paraqitjes së rezultateve dhe publikimi i të dhënave**

Çdo paraqitje e rezultateve të biznesit të një shoqërie investimi me ofertë private përbëhet nga të dhënat më të fundit, të disponueshme në çastin e paraqitjes së rezultateve të biznesit dhe hartohet në mënyrë të njëtrajtshme, për sa u përket periudhave të mbuluara, me përfshirjen ose përjashtimin e faktorëve të veçantë, të cilët ndikojnë në këto rezultate, p.sh. bazat për çmimin, kostot, taksat, dividendët etj.

### **5) Politika e investimit të një shoqërie investimi me ofertë private**

Kërkesat, ndalimet dhe kufizimet e sakta për politikën e investimit të një shoqërie investimi me ofertë private përcaktohen me rregullore të veçantë të AMF-së.

## **VI. Shitja e aksioneve ose e kuotave në sipërmarrjet e investimeve kolektive**

Shitja e aksioneve ose e kuotave në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike kryhet nga shoqëritë administruese si dhe nga bankat, shoqëritë e sigurimit, shoqëritë komisionere apo nga persona të tjerë juridikë, që kryejnë transaksione shitjeje për shoqërinë administruese, në bazë të një kontrate bashkëpunimi ndërmjet palëve.

## **VII. Përcaktimi i vlerës së aseteve dhe i çmimit të aksioneve e të kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive**

### **Frekuenca e llogaritjes së vlerës**

Shoqëria administruese duhet të përcaktojë vlerën e aseteve të fondit të investimeve dhe të të gjitha detyrimeve e tarifave të saj, para se të llogarisë vlerën neto të aseteve për çdo kuotë apo çmimin për çdo kuotë

- Vlera neto e aseteve të një fondi investimi llogaritet ditë për ditë, në kohën e treguar në prospekt. Shoqëria administruese njofton AMF-në ditën tjetër të punës për vlerën e aseteve të fondit të investimit, detyrimet dhe tarifatat e tij, si dhe për çmimin e kuotave të fondit të investimit, siç janë në datën e llogaritjes.
- Vlera neto e aseteve të një shoqërie investimi llogaritet të paktën një herë në muaj, në kohën e treguar në prospekt.  AMF-ja miraton një rregullore të posaçme, duke specifikuar frekuenca të ndryshme, për përcaktimin e vlerës neto të aseteve.

## **Parimet dhe mënyra e përcaktimit të vlerës së portofolit të sipërmarrjes së investimeve kolektive**

Llogaritja e vlerës së portofolit duhet të sigurojë trajtim të njëjtë për të gjithë investitorët në sipërmarrjen e investimeve kolektive, pavarësisht llojit të sipërmarrjes ose faktit nëse kjo është një sipërmarrje me ofertë publike apo private.

**Në rastin e titujve**, përfshirë aksionet e shoqërive të investimit, përcaktimi i vlerës së aseteve bazohet në çmimin e tregut, që zbatohet në tregjet e organizuara dhe të rregulluara.

**Në rastin kur nuk kemi çmim tregu**, çmimi i transaksionit të fundit, të përfunduar për atë titull, ose rendimenti nga transaksioni i fundit, në rastin e titujve të borxhit, përdoret si bazë për llogaritjen e vlerës së aseteve.

**Në rastin e depozitave dhe llogarive rrjedhëse ose ekuivalentëve të tyre monetarë**, pretendimeve dhe detyrimeve afatshkurtra dhe të të ardhurave e shpenzimeve të ardhshme, vlera nominale e përdorur zmadhohet me interesin e akumuluar, nëse nuk është parashikuar ndryshe nga AMF-ja.

**Në rastin e formave të tjera të aseteve, të cilat nuk kanë çmim tregu**, vlerësohet vlera e drejtë dhe e arsyeshme e këtyre aseteve. Procedurat për përcaktimin e vlerës së drejtë dhe të arsyeshme të aseteve përfshijnë vlerën kohore, duke skontuar rrjedhën e parave, krahasimet me asetet e ngjashme me çmim të njohur në treg, metodat e vlerësimit me opsione dhe mënyrat e tjera, të parashikuara nga AMF-ja.

**Baza për përcaktimin e vlerës së aseteve** specifikohet në prospektin dhe rregullat e fondit dhe zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme për çdo llogaritje të vlerës së aseteve të fondit.

## **VIII. Mbikëqyrja nga AMF-ja**

AMF-ja është përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë së sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive administruese, depozitarëve, si dhe çdo subjekti tjetër, që vepron si i tillë pa miratimin e shprehur të AMF-së dhe të dhënë në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Veprimtaria mbikëqyrëse e ndërmarrë nga AMF-ja realizohet me anë të:

- inspektimeve në vend të çdo dokumenti, që lidhet me objektin e veprimtarisë të subjektit. Ky inspektim realizohet me ose pa njoftimin paraprak të subjektit të mbikëqyrur;
- marrjes dhe analizimit të raportimeve, siç është parashikuar në këtë ligj;
- zbatimit të masave të ndërmarra, siç është parashikuar në këtë ligj.

## **IX. Kundërvajtjet penale dhe masat ndëshkimore**

Për respektimin e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, ligjvënësi ka miratuar një sërë masash parandaluese dhe ndëshkuese për të luftuar kundërvajtjet e mundshme.

**Av. Armer JUKA**